

Komisioni për shpalljen e konkursit për *Shpërblimin mbështetës* të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i caktuar nga Kryesia e Akademisë në mbledhjen e datës 5 mars 2025, bazuar në vendimin e Kryesisë së Akademisë për themelimin e *Shpërblimit mbështetës*, nr. 230 dt. 31.12.2013 dhe vendimit të Kryesisë së Akademisë për shpalljen e *Shpërblimit mbështetës* për vitin 2024, nr.256/1 , dt. 5 mars 2025, shpall

## KONKURS

Për ndarjen e *Shpërblimit mbështetës*.

Me qëllim të stimulimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve, Kryesia e Akademisë ka vendosur që për vitin 2024 të ndajë çmimin me vlerë prej 3,000.00 Euro kandidatit/es – shkencëtarit/es të ri deri në moshën 35 vjeç, që ka arritje të larta në fushën e studimeve shkencore gjatë karrierës së tij/saj të deritanishme.

Çmimi jepet me qëllim vlerësimi dhe promovim të arritjeve shkencore të brezit të ri, që është edhe një ndër objektivat kyçe të planit strategjik të ASHAK-ut dhe programit Kombëtar të Shkencës.

Kriteret e aplikimit:

Të drejtë aplikimi kanë shkencëtarët/et kosovarë të disiplinave shkencore në kuadër të shkencave shoqërore, shkencave sociale, albanologjisë, shkencave të natyrës dhe të atyre teknike, si dhe të arteve, të cilët/at kanë dëshmi për rezultatet e arritura në punën e tyre hulumtuese-shkencore.

Kandidatët/et duhet të dorëzojnë dokumentacionin në formë elektronike, në formatin PDF, në emailin: [ashak@ashak.org](mailto:ashak@ashak.org) , si në vijim:

- CV –në;
- Listën e publikimeve të së paku dy punimeve shkencore si autor/e i parë, të botuara në revistat që gjenden në platformat shkencore (Scopus dhe Web of Science);
- Listën e publikimeve shkencore ndërkombëtare;
- Titullin e veprës eventuale të botuar studimore;
- Certifikatën e shtetësisë të Republikës së Kosovës;
- Certifikatën e lindjes.

Kandidatët/et që i plotësojnë kushtet e mësipërme do të vlerësohen edhe për pjesëmarrje me prezantim në kongrese, konferenca ose simpoziume ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrje në projekte shkencore.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë, 11 mars deri më 9 prill 2025.

Aplikimi është individual.

Aplikacionet e pakompletuara dhe ato jashtë afatit nuk do të shqyrtohen.

